




Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo



AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Dep		Nr Prot	
Dep	<u>DPK</u>	Bi Prot	<u>03-03/1493/18</u>
Dep		Prot No	
Nr. 1336		Data	
Bi/shtamca	<u>03</u>	Datum	<u>25-05-2018</u>
Nr. pages		Date	

DATË/A:	25.05.2018
REFERENC-Ë:	AKK-DPKPP /03-03-1469/18
PËR/ZA/TO:	z. Zekë BARDHAJ, Udhëheqës i Zyrës së Prokurimit në Komunën e Prishtinës
CC:	z. Shpend AHMETI, Kryetar i Komunës së Prishtinës
NGA/OD/FROM:	Shaip HAVOLLI, Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin "Asfaltimi i rrugës Matiqan, Butovc, Kolovicë "



I nderuari z. BARDHAJ,

Në mbështetje të nenit 142 (par. 3) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 5 (par. 1, nënpar. 1.1.) dhe 21 të Ligjit nr. 03/L-159, për Agjencinë kundër Korrupsionit, nenit 9 (par. 1, nënpar. 1.5.), 16 (par. 2) dhe 21 (par. 3) të Ligjit nr. 06/L-011 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, si dhe të nenit 23 të Rregullores nr. 01/2014, së Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, lidhur me tenderin me titull "Asfaltimi i rrugës Matiqan, Butovc, Kolovicë ", me nr. të prokurimit: 616-18-3470-512 dhe me nr. të brendshëm: 616-18-061-512, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme drejt evitimit të shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin "Asfaltimi i rrugës Matiqan, Butovc, Kolovicë ", me nr. të prokurimit: 616-18-3470-512 dhe me nr. të brendshëm: 616-18-061-512, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit për prokurimin publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Arsy etimi

Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtejme Agjencia), duke vepruar sipas detyrës zyrtare pas kontrollimit të njoftimeve për kontratë që ka bërë në Sistemin elektronik të Prokurimit, me datë 23.05.2018, ka nxjerrë vendim me numër protokolli: *AKK-03-03-1469/18*, për fillimin e procedurës për trajtimin e rastit në lidhje me aktivitetin e prokurimit publik me titull **"Asfaltimi i rrugës Matiqan, Butovc, Kolovicë "**, me nr. të prokurimit: *616-18-3470-512* dhe me nr. të brendshëm: *616-18-061-512*, i iniciuar nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Prishtinës.

Agjencia në bazë të dokumenteve të nxjerra nga platforma **E-Prokurimi** ka analizuar njoftimin për kontratë dhe dokumentin e parakualifikimit, ku ka konstatuar se Autoriteti Kontraktues, për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë procedurë të kufizuar, kontratë publike të llojit punë, me vlerë të madhe prej 980,686.75 €. Agjencia, pasi ka analizuar me kujdes njoftimin për kontratë dhe dokumentin e parakualifikimit ka vërejtur se tek rubrika *III.2.4. Kapaciteti teknik dhe profesional tek kërkesa 1*, Autoriteti Kontraktues, ka kërkuar nga Operatorët Ekonomik të ofrojnë dëshmi se kanë përfunduar me sukses asfaltim të rrugëve në vlerë minimale prej 700,000.00 €, në tri vitet e fundit (duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë). Vlera e se cilit projekt të realizuar duhet të jetë minimum 150,000.00 €. **Kërkesë kjo për të cilën AKK konsideron se nuk është në pajtim me dispozitat e Ligjit në fuqi për prokurimin publik më saktësisht me nenin 69.**

Sipas Ligjit në fuqi për Prokurimin Publik më saktësisht në nenin 69 paragrafi 6.2. parashihet se Autoriteti Kontraktues mund të kërkoj " Listën me të cilën specifikohen të gjitha projektet e punëve dhe aktivitetet ndërtimore të realizuara në periudhën e shkuar trevjeçare, të përcjella me certifikata për kryerje dhe/ose përfundim të kënaqshëm të projekteve më të rëndësishme të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore; certifikatat përcaktojnë vlerën, datën dhe vendndodhjen e projekteve të punëve dhe/ose aktiviteteve ndërtimore dhe specifikojnë nëse janë kryer dhe/ose përmbushur në përputhje me rregullat tregtare dhe janë përfunduar siç duhet; sa herë që është e mundur, Autoriteti Kontraktues mund të obligohet që të dakordohet me Autoritetin Publik kompetent në Kosovë ose në vendin tjetër që kopjet e certifikatave përkatëse të i'a paraqes drejtpërdrejtë Autoritetit Kontraktues.

Pra në këtë rast do duhej të kërkohej lista e kontratave bashkangjitur si dëshmi referencat mbi përfundimin e kontratave në vlerë totale të gjitha referencave të punëve të ngjashme të realizuara në tri vitet e fundit para publikimit të njoftimit për kontratë e jo si në rastin konkret ku është kufizuar që vlera e se cilit projekt të realizuar duhet të jetë minimum në shumën prej 150,000.00 €.

Konsiderojmë se veprimet e tilla si në rastin konkret e kufizojnë konkurrencën e lirë dhe diskriminojnë Operatorët ekonomik të cilët mund të bëjnë ekzekutimin e punimeve të ngjashme, andaj, Autoriteti Kontraktues duhet të këtë kujdes që të caktoj kërkesa minimale të kualifikimit.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues, konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi nenin 27 Dosja e Tenderit dhe nenin 69 Kapaciteti teknik/profesional të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04-L/042 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L -237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin nr. 05/L-092.

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në aktivitete të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsionit rekomandon që të evitohen këto shkelje, përmes njoftimit standard për informata shtesë dhe për përmirësimin e gabimeve, duke i njoftuar Operatorët të cilët e kanë tërhequr dosjen e këtij tenderi.

Po ashtu ju njoftojmë se lidhur me këto të gjetura do të njoftohet Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – KRPP.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !

04/03/2017